



Prot. Nr115 - Comunicato Stampa

L'evento organizzato dalla Federazione Nazionale delle Associazioni Albanesi in Italia (FNAI)

l'11 dicembre 2022, alle ore 10:00,

all'Hotel Maestro,

via Apollonio 72, Brescia,

Evento " Diaspora 22" che ha trattato due temi importanti:

- Il Contributo della Donna nella Società Civile – avv. Agron Xhanaj
- Diaspora Locomotiva del Progresso – Prof.ssa Dava Gjoka

L'evento è stato moderato dalla segretaria della Federazione ing. Erida Cela e il vicepresidente sig. Granit Mucaj ha dato inizio alla conferenza trattando “ Problemi organizzativi e all'attività della Federazione Nazionale”

Ringraziamo le nostre associazioni, membri, relatori e i nostri ospiti illustri, in particolar modo

l' Assessora di Brescia Morelli, i rappresentati del Consolato di Milano d' Albania e del Kosovo (che sono intervenuti dando un valore aggiunto a questo evento)..

L'evento è stato pubblicato su YOU TUBE (4 Video , preparati da Erida Cela dove si parla in due lingue albanese ed italiano)

L'evento è stato pubblicato nel Gruppo FB di Federazione FNAI –

Gruppo FB: FEDERATA KOMBËTARE E SHOQATAVE SHQIPTARE - ITALI

Da Erida Cela – Segretaria FNAI

Prot. nr 115

Komunikatë për Eventin “ Diaspora 22”

Nga zëdhënësi i FNAIT z. Ndue Shabaku ,
dt. 12/12/2022 me titull:

Shtysë e mekanizmave shoqërore

Edhe këtë vit, Federata Kombëtare e Shoqatave në Itali e zhvilloi veprimtarinë e saj të përvitshme në qytetin verior të Italisë Brescia. Ishte me kohë ndër objektivat parësorë të Federatës, ndaj, për oorganizimin e këtij event, diskutoi para disa javësh. Pasi përcaktoi se çfarë do të arrihej, u zgjodh grupi i punës, i cili ndau detyrat për të realizuar secili nga anëtarët një pjesë të punëve përgatitore, sipas mundësive, aftësive dhe përvojave të fituara në vite, për të ndërtuar të tërën.

Grupi i Përkohshëm Organizator medoi përsëri që event të zhvillohej sipas traditës, në dy faza. Në fazën e parë të zhvillohej një Konferencë me orientim të theksuar shoqëror dhe në pjesën e dytë, të vazhdonte me Drekën Festive argëtuese.

Pas vënies në funksion të fonisë, videoprojektorit dhe sistemimit të personave në vendet e rezervuara, para auditorit hapi siparin e Konferencës me zërin e saj miklues dr.ssa Anisa Karagjozi, aktiviste e hershme dhe e ngarkuar me detyra të rëndësishme në Federatë. Pasi prezantoi Grupin Organizator, proklamoi qëllimin e kësaj Konferencë. Ftoi zonjat e zotërinjtë e nderuar Granit Muçaj, Luljeta Çobanaj, Dava Gjoka, Avv. Agron Xhanaj, Erida Çela të zinin vendin në panelin drejtues dhe i dha fjalën moderatores së Konferencës.

Grupi Organizator mbajti parasysh parimin që gjithësecilit i vjen turni të shprehë aftësitë dhe vlerat që ka. Duke pasur prezente zotësitë si drejtuese dhe kapacitetet intelektuale, njëzëri iu besua detyra si modretaore, ing. Erida Çela Përlala. Hezitimet e fillimit u shndërruan në guxim. Ajo u vu në punë dhe përgatiti programin e Konferencës, duke përcaktuar radhën e relatorëve dhe personave që do të përshëndesnin.

Së pari, uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe prezantoi autoritetet lokale e të përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, që kishin vlerësuar pozitivisht ftesën.

I pari nga relatorët e mori fjalën Zëvendës-presidenti i Federatës, Granit Muçaj. Në fjalën e tij bëri një sintezë të veprimtarisë së FNAI-t, duke trajtuar problemet organizative, orientimet dhe objektivat vjetore e afatgjata si dhe për mundësitë e mënyrat që veprimtaritë të mbahen të gjalla, për promovimin e kulturës sonë. Me shumë takt u drejtoi thirrje të gjitha organizimeve shoqërore që të forcojnë frymën e respektit reciprok dhe të bashkëpunimit, si në ngritjen e problemeve të dy shtet, si në përkrahjen e vlerave pozitive të komunitetit tonë në Itali.

Moderatorja theksoi që kësaj here Konferenca do të ketë karakter të mprehtë shoqëror dhe do të trajtojë tema delikate, por jetike. Pasi bëri prezantimin e një personaliteti tepër të zot, për të trajtuar problemin e parë, ftoi avokatin penalist Agron Xhanaj, për tjetër i

njohur nga komuniteti dhe për kontributin e tij si autor librash letrarë. "Pozicioni i femrës në shoqërinë e sotme" e kishte titulluar temën që kishte përgatitur. Pra, temë shumë e trajtuar në forume, media, organet ligjvënëse, por përsëri ka vend për të folur. Kjo tregon se ka akoma probleme. Kjo së pari, sipas avokatit, sepse femra është qenie delikate dhe lehtësisht e cënueshme. Ndaj, krahas emancipimit të femrës, duhet doemos emancipimi i mashkullit. Pastaj theksoi rolin e madh që ka celula e shoqërisë; familja. Ato janë vatra të edukimit dhe aty duhen gjërat të hapura e praktike. Edhe ndërmarrjet duan pranë vetes persona të mancipuar, për çuar përpaa mekanizmat ekonomike prej nga rrjedhin problemet shoqërore. Pastaj theksoi rëndësinë e madhe që ka lidhja e shoqërisë me shtetin, me ligjet, me rregullat, me normat.

- Ne si individë duhet të jemi miq me shtetin e të japim kontribut qytetar, - theksoi ai. Moderatoja e pati prezantuar më parë dhe kësaj radhe, pas avokatit, i dha fjalën zonjës Roberta Morelli, Assessore delle Pari Oportunita pranë komunës Brescia.

- Sono lieta di portare tra voi i saluti del Sindaco di Brescia ..." (Jam e lumtur të sjell mes jush përshëndetjet e Kryetarit të Bashkisë Breshia ...), - e hapi fjalën e saj zonja Morelli. Më pas me qëndrim serioz, por shumë admirues falënderoi ekipin mjekësor shqiptar që gjatë pandemisë erdhi në ndihmë pikërisht në Brescia. Duke iu referuar edhe fjalës së avokatit, përmendi faktin që në administratën shqiptare janë mbi 50% femra, ndërsa në vendin ku jetojmë, këto shifra janë defiçitare. Ajo vazhdoi të flasë për veprimtaritë e organizuara për të ndërgjegjësuar femrën në përgjithësi. Më pas përmendi disa shifra që tregojnë se akoma pozita e femrës në shoqëri duhet të vihet në rolin që meriton.

Edhe për problemet e emigracionit është folur shumë. Për të referuar rreth rolit të faktorit emigracion, moderatorja i dha fjalën profesores së filozofisë Dava Gjoka, që kambaruar universitetin në Tiranë dhe i ka përfeksionuar studimet në nivelin master në universitetin famoz "Bocconi" në Milano. Që titullin e temës, "Diaspora, lokomotivë e progresit" kuptojmë me sa optimizëm e kishte përgatitur referimin. Ajo u ndal tek mundimet e emigrantëve të parë, tek situata krejt ndryshe nga iluzionet e krijuara dhe përpjekjet epike për të mbijetuar. Me shumë përkujdesje e me shumë zotësi oratorja foli për emigrantin si qenie në një mjedis ndryshe, ku nuk vlerësohet për rekuzitet njerëzore që ka. Ajo solli disa përvoja nga puna e saj për të ilustruar mendimet tepër të kualifikuara e të para në aspektin human e filozofik. Ajo foli për rolin tepër pozitiv të emigracionit shqiptar në Itali, për lidhjet dhe integrimin në shoqërinë italiane përmes vlerave reale. Pastaj përmendi kontributin direkt në rritjen e parametrave ekonomikë e shoqëror në vendlindje. Një problem delikat e shqetësues parashtrroi në fjalën e saj lidhur me votën që u është privuar për dekada me radhë votuesve në diasporë. Në fund të ligjërimit solli në auditor lajmin që Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë shqyrtoi kërkesën e një organizmi shoqëror në diasporë dhe ka përcaktuar antikushtetuese mohimin e votës së emigrantëve, për shkak të boshllëkut ligjor të përshtatshëm. Ndërkohë, kjo gjykatë detyron Parlamentin Shqiptar që brenda vitit të plotësojë dispozitat ligjore, për të garantuar edhe votën e diasporës.

Pasi falënderoi përzemërsisht relatorët, moderatorja Erida kaloi në përshëndetjet. Konsulli i Republikës së Kosovës në Milano, zoti Diamant Kastrati, solli përshëndetjet e qeverisë kosovare. Pastaj përgëzoi Federatën veprimtarinë me tepër sens qytetarie dhe shprehu gjithë mbështetjen e tij.

- 240 mijë euro janë shpenzuar për ngritjen e Qendrës Kulturore "Margarita Xhepa" në Asti dhe të gjitha janë kontribut i komunitetit shqiptar, - theksoi në përshëndetjen e tij, prof. Hasan Bulçari. Ai tha që çdo ditë Qendra Kulturore është e hapur e zhvillohen kurse të ndryshme. Pastaj tërhoqi vëmendjen të kemi më respekt për flamurin tonë. Si gjithnjë tepër pozitive në fjalën e saj koordinatoresha pranë Konsullatës, Luljeta Çobanaj. Së pari iu referua historisë së emigrantëve dhe e përshkroi me ndjesitë nga dëshpërimi për parrullat denigruese për shqiptarët nëpër mure, deri tek statistikat komfortante që falsin për integrimin dinjitoz të komunitetit tonë në shoqërinë ku kemi zgjedhur të jetojmë. Disa herë ka ardhur nga Milano e mbështetur direkt veprimtaritë tona në terren Konsulli i nderuar Rezart Shkëmbi. Shpesh kemi diskutuar miqësisht e institucionalisht me të. Por kësaj herë patëm rastin e bukur t'ia dëgjojmë zërin në mikrofonin e Konferencës. Së pari falënderoi zonjën Moreli për ndjesinë e përkujdesjen ndaj komunitetit dhe veçanërisht, ndaj këtij eventit. Më pas foli për rëndësinë që kanë organizimet shoqërore për bashkëpunim dhe për të fituar eksperiencë. U shpreh që është i ndërgjegjshëm që, të bësh punë vullnetare, është e vështirë për shumë arsye. Më pas na përgëzoi për veprimtaritë promovuese si shtysë e mekanizmave shoqërore.

Pas Konferencës u bë një modifikim i vogël i sallës dhe u përshtat gjithçka për të filluar Drekën Festive. Panelin drejtues e zëvendësoi mjeshtri i muzikës [Skender Gobja](#) me pajisjet e mikrofonat. Të ftuarit, pranishmit në Konferencë dhe të tjerë që preferuan të vijnë vetëm në drekë, u sistemuan nëpër tavolinat e përgatitura që më parë. Siç ishte njoftuar më parë, për moderimin e Drekës Festive ishte i pranishëm një person shumë i njohur përmes mediave dhe në komunikimin simpatik në rrjetet sociale. Ai kishte ardhur nga Ravenna me zonjën e tij, me djalin e dytë dhe me nipin e tij që jeton në Modena. Në Grupin organizator kishte marrë përsipër moderimin e drekës dhe, ja, mbaroi pritja. Kështu, publicisti e radiokronisti nga Elbasani, [Sefer Kikija](#) hapi sparin e Drekës me fjalën e tij të zjarrtë. Thirri Sekretaren e Përgjithëshme, zonjën Erida Çela, për të përshëndetur të pranishmit. Në emër të FNAI-t përshëndeti dhe uroi mirëseardhjen të pranishmëve. Kështu nisi edhe maratona e prezantimit të personave, lojërave, dhuratave e surprizave të cilat altermoheshin me muzikën e zgjedhur enkas. Gjatë kohës përshëndetën disa drejtues të shoqatave anëtare, aktivistë, artistë dhe kontribues të drejtpërdrejtë në themelimin e FNAI-t. Për këtë të fundit përshëndeti juristja e nderuar Marjola Begaj, e cila ka kontribuar për muaj të tërë, për të përgatitur anën juridike e pozicionin legal të Federatës. Gazetari Zefer Kikija synoi më shumë t'u jetet fjala personave që nuk patën mundësi të flasin në Konferencë. Përshëndetën drejtues shoqatash si Adela Shehu, Presidente e shoqatës "Arbëria", e cila kishte ardhur nga Trieste me një skuadër simpatike të përbërë nga tre motra. Dëgjuam zërin e Presidentit të shoqatës "Aquila", të nderuarin Astrit Hysko, i cili preferon të mos flasë shumë, por të dalë në evidencë puna e vazhdueshme. Befasisht iu drejtua mikrofonin një aktivisti që kishte ardhur nga Fermo i largët dhe përshëndeti me entuziazëm. Edhe Dea, tifoze e adashes së vet Atalanta, u prezantua befasisht, para mamit të saj, dr. Anila Cenolli, e cila ka qenë Presidente e Federatës për disa kohë. Ne kishim fatin të gjendeshin mes nesh miq tepër të nderuar nga Asti. Të gjithë kanë dëgjuar për kontributin tepër të madh për kulturën shqiptare. Presidenti i shoqatës AssoAlbania, zoti Marjan Bjeshtëza pati

pjesëmarrje simpatike në lojërat e shumë serioz në fjalët përshëndetëse. Patën nderin e madh të na deklaronte se do të nisnin procedurën e aderimit në Federatë. Një lajm tepër i gëzueshëm për të gjithë ne, pasi gama e serioziteti i bashkëpunimit me ta, sjell stimuj e angzhime më të kualifikuara.

Tepër simpatike loja e prezantimit të artistëve prezentë. Është luks të kesh artistë si regjizorja nga Tirana Valbona Xibri, e cila ka sukses të madh në punën e saj profesionale. Me pak fjalë u prezantua artizania e talentuar Ninfa Pema. Me fjalën e saj autoritare foli piktorja me dhunti të rralla krijuese, Alketa Bercaj. Sapo ishte kthyer nga vendlindja dhe përmendi punën e saj humanitare gjatë qëndrimit në Atdhe.

Sfiduese ishte loja në të cilën prestidigjitori Sefer Kikija fitoi bastin e gjeti yllin femër. Moderatorin thirri në pranë këngëtares e Stela Gjeçi, vajza çiftit nga Kavaja Kela e Gentian, tashmë, përherë të pranishëm me simpatinë e tyre. Stela është nxënëse e klasës së tretë një një lice për kanto. Për kënaqësinë tonë këndoi me mjeshtri e virtuoze dy këngë, të shoqëruara me shumë duartrokitje. Moderatorin i shumë roleve u vu në kërkim të një emri mitesh e legjendash. Nuk u ndal pa gjetur emrin Zana. Më në fund, zbuloi se bashkëshortja e Angelo Alimanit quhet Zana. Me shumë dashamirësi, poetja Suzana Alimani përshëndeti me pak fjalë e me vargje të një lirike shoqërore në linjë me temën e referuar më parë. Tepër të çmuara, jo vetëm për atmosferën, ishin dhuratat që moderatori bashkë me familjen e tij kishin sjellë për këtë ditë feste. Sëpari loja me dy topa kuq e zi dhe loja me një glob, një shall e një kapuç, ku i fituan disa fëmijë të pranishëm.

Herë pas here muzika ftonte të pasionuarit të hidhnin valet tona popullore, deri sa erdhi momenti për të shpërndarë disa Certifikata Mirënjohjeje disa Cetifikata Nderi. Me ta Këshilli Drejtues nderoi eksponetë të Federatës, aktivistë e drejtues shoqatash e disa drejtues eventesh me rëndësi gjatë viteve. Më në fund ishte vendosur të jepj çmimi i madh "Personzhi i Vitit", i shpallur nga FNAI. Duke vlerësuar arritjet e mëdha gjatë këtij viti, u vndos që për merita të barabarta, të ndaheshin dy çmime "Personazhi i Vitit". Ky çmim iu dha zonjës Leonora Zefi, për realizimin e veprës madore, Obeliskut të Skënderbeut, në Trento dhe zotit Sherif Nuredini, për realizimin e veprës madhore Shtatorja e Nënë Terezës në Darfo Borario Terme (BS).

Duke përmbledhur themi se veprimtaria e dyfishtë e datës 11 dhjetor 2022 në Hotel Master, Brescia, pati dy anë. Ana e parë, serioziteti e përgjegjësia në Konferencë, dhe ana tjetër, alegria e dëfrimi, në Drekën festive. Përgjithësisht, opinioni i të gjitha shoqatave dhe individëve të Federatës e pjesëmarrësve në event, është që kësaj here ka qenë veprimtaria më e arrirë. Kjo falë disa faktorëve. Faktori i parë ka qenë puna organizative parapërgatitore që i ka paraprirë këtij event. Kanë merita tepër të mëdha dy moderatorët që morën përsipër detyra të vështira dhe ia doli më së miri secili në rolin e vet. Çdo gjë në Konferencë shkoi më mirë se kishim pritshmërinë. Secilit prej protagonistëve iu dha mundësia të punonte e të shprehte në moderim e referim idenë e tij/saj. Kështu ndihej secili i çliruar nga komplekset dhe i prirur të respektojë përgjegjësitë e tij. Moderatorja Erida, referuesit av. Agron Xhanaj e Dava Gjoka, me integritet të lartë kulturor e kapacitete profesionale të admirueshme, e ftuara speciale signora Roberta Morelli, personalitet diplomatike të Republikës së Kosovës e Republikës së Shqipërisë në Milano për vlerësimin e seriozitetin e eventit dhe mesazhet e



tyre, zoti Hasan Bulçari që solli zërin ushtues të Astit, i dhanë Konferencës tonalitet të lartë e në sfond dukej një farë solemniteti natyral.

Gjithçka u transmetua në këtë event, është rezultat i vullnetit të pastër, i ambicieve pozitive, i bashkëpunimit të sinqertë. Faktorë që për FNAI-n do të mbeten baza e shëndetshme për të realizuar gjëra të vlefshme për komunitetin tonë.